

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve
ADRESA	https://lapsi.al/euro-vijon-rrokullisjen-prek-rekord-te-ri-ne-vleren-e-91-4-lekeve-i1094268
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 05:49:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0a002a89b0118417e5e526acd01432d91d88890c30b1d30f4be6ed240fa2dee2
TEKSTI	ba5fac34a2e161d07991416fac804d7fdd3e5ccf7d9648f88afe8897b94eb61c
PAMJA	937ab859a4553c4afa7fffee6568b3632c4b977944d6798aaa985ef449be7e9e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fddf9cba9416350f2fe3324df8b89ec740fb401070b42dbfe285a41eba8fdd99
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fddf9cba9416350f2fe3324df8b89ec740fb401070b42dbfe285a41eba8fdd99>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve



LAPSI.AL • 23 SEPTEMBER 2026



Kursi i këmbimit të Euros me Lekun po pëson rënie të mëtejshme këtë javë. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, Euro u këmbye sot me 91.4 lekë, niveli më i ulët i të gjitha kohërave. Rënia e vazhdueshme e Euros që prej tremujorit të parë të këtij viti i ka përshpejtuar ndjeshëm ritmet e rënies vjetore të monedhës europiane. Që prej fillimit të vitit kalendarik, kursi i këmbimit Euro - Lek ka rënë me 5.5%, ndërsa me bazë vjetore rënia ka arritur në 5.7%.

Agjentët mendojnë se kursi po vazhdon të bjerë, në inercinë e sezonit veror që ka sjellë flukse të mëdha valutore hyrëse, ndërkohë që kërkesa për valutën europiane paraqitet e dobët. Zhvlerësimi i monedhës europiane duket se ka nisur ta ulë përdorimin e saj edhe në transaksionet e shitblerjes së aseteve në tregun e brendshëm, si për shembull në tregun e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë, edhe depozitat në Euro po rriten me ritme më të ngadalta, duke sugjeruar një lloj rritjeje të preferencës së publikut për t'i mbajtur kursimet në monedhën vendase.

Këta faktorë kanë tendencën të forcojnë më tej tendencat rënëse të kursit të Euros, që, në vija të përgjithshme, po vijojnë prej më shumë se një dekadë, të nxitura nga tendencat e përmirësimit strukturor në pozicionin e jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Ky përmirësim afatgjatë mund të shpjegohet me rritjen e të ardhurave nga turizmi dhe zgjerimin e eksportit të shërbimeve, me rritjen e investimeve të huaja direkte, sidomos në pasuri të paluajtshme, por pjesërisht edhe me një rol të konsiderueshëm që perceptohet se luajnë prurjet valutore informale.

Statistikat e Bankës së Shqipërisë tregojnë një përmirësim të ndjeshëm të Bilancit të Pagesave edhe në gjysmën e parë të këtij viti. Për 6-mujorin 2026, deficit i llogarisë korrente pësoi rënie, me një vlerë totale prej 361 milionë eurosh ose 40.6% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

ide



Rënia e Vlorës në shtratin e kimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTITIRANA

12°C

KËMBIMIEURO

91.40

aktuale

21:41

Dita e 115-të e protestës/ Nuk mungojnë mesazhet e Vlorë Hysenit



Protesta nuk ndalet, qytetarët rikthehen sot para Kryeministrit: Rama jep dorëheqjen



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Deficiti i llogarisë korrente për 6-mujorin ka shënuar njëkohësisht nivelin më të ulët që prej vitit 2018. Ulja e deficitit ka ardhur kryesisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve dhe nga remitancat. Bilanci në tregtinë e shërbimeve ishte pozitiv në vlerën e afërsisht 1.79 miliardë eurove, në rritje me 12.9% krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar.

Më shumë se gjysma e kontributit në sektorin shërbimeve erdhi nga turizmi, që në 6-mujorin e parë të vitit i solli ekonomisë të ardhura neto në vlerën e 957 milionë eurove, në rritje me 20% krahasuar me gjysmën e parë të vitit të kaluar.

Efekt shtesë në bilancin e përgjithshëm duket të ketë dhënë edhe rritja e fortë e investimeve të huaja direkte. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se për tremujorin e dytë 2026 vlera e investimeve të huaja direkte arriti në 741 milionë euro, në rritje me 86% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kjo rritje u ndikua ndjeshëm nga flukse të lidhura me një projekt të rëndësishëm zhvillimi në sektorin e pasurive të paluajtshme. Për të gjithë 6-mujorin e parë, vlera e përgjithshme e investimeve të huaja direkte arriti në 1.144 miliardë euro, me një rritje prej 50% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjithashtu, një efekt shtesë duket se po ushtron edhe suficiti i bollshëm fiskal, që po ul ofertën e Lekut në treg. Për 8-mujorin 2026, buxheti ishte në suficit në vlerën e 61.6 miliardë lekëve, në rritje me 52% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë./Monitor

Të këshilluara



Shuhet zjarri në Gjirin e Lalëzit, aktive mbetet vatra në pyllin e Bizës

Zjarri masiv që përfshiu mbrëmjen e së martës Gjirin e Lalëzit është shuar rreth orës 02:00 të mëngjesit...



Takimi me Trump, Zelensky i gatshëm të takohet me Putin: Në çdo kohë

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se ishte gati në çdo kohë të takohet me udhëheqësin rus Vladimir Putin në njëseu...



Kostoja e shëndetit në Shqipëri është e dyta më e lartë në Europë



Video që tregon se Rama e dinte paraprakisht për Vlora Hysenin



Arrestohet në Morinë shefja e SHISH, Vlora Hyseni



Ambasada amerikane mesazh për sigurinë, pasi u shpall në kërkim drejtuesja e SHISH



SPAK reagon zyrtarisht për "arrestin" e shefes së SHISH



Kthjellime dhe vranesira kalimtare/ Parashikimi i motit për sot

Sot vendi ynë do të ndikohet nga të njëjta kushte atmosferike. Moti parashikohet i kthjellët në të gjithë territorin p&...



FOTOLAJM/ Momenti kur makina e Vlora Hysenit vjen në Morinë

Shefja e shkarkuar e SHISH, Vlora Hyseni u vendos në masën e arrestit shtëpiak mbrëmjen e së martës. Ajo u vetëdorëz...



Berisha flet për mediat italiane: Pse i mbështes protestat dhe nevoja për qeveri teknike

Për më shumë se 100 ditë, mijëra qytetarë shqiptarë kanë dalë në rrugë për të protestuar kundë...



PAMJET/ Zjarr i përmasave të mëdha në Gjirin e Lalzit



Dalin detaje të reja/ Policia e priste në Rinas, Vlora Hyseni u shfaq në Prishtinë

Detaje të reja mësohen nga dorëzimi te autoritetet shqiptare në kufi me Kosovën, i kryetares së SHISH, Vlora Hyseni. Sipas burime...



Dita e 115-të e protestës/ Nuk mungojnë mesazhet e Vlora Hysenit

Protesta mbylli të martën ditën e saj të 115-të. Si çdo ditë tjetër, protestuesit u grumbulluan në sheshin ...



Shkëlqimi dhe rënia e Vlora Hysenit/ Shefja e SHISH nën hetim në dosjen e AKSHI-t

Tre vjet pas emërimit, gruaja që Rama e cilësoi si një "garanci të plotë" për inteligjencën shqiptare është pezulluar nga detyra dhe vendosur në "arrest në shtëpi" në kuadër të një hetimi të SPAK, i cili lidhet me dosjen për manipulimin e tenderëve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Me sytë katër



21:27

PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

Një rekord botëror i pabesueshëm - dhe jo një herë, por dy herë - u thye brenda 3 ditësh nga 6-vjeçarja Lian Yunji ng...



PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

20:52



Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlora Hyseni

16:12



ERRALLE/ Trump del në TV pa zë për shkak të bojkotit të mediave

22:10



Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

21:02

SPORT

→ Të tjerë artikuj



19:46

Çështja e arbitrimin, Tebas sulmon Real Madrid: "Jeton në galaktikë tjetër". Replika e Blancos: "Fjalë të padenja"



19:27

Balliu rrezikon të mos jetë kundër Bjellorusisë: u dëmtua me Rayo Vallecano, po monitorohet nga mjekët



15:06

Izraeli i përgjigjet trajnerit të Irlandës: "Ende nuk kemi zbuluar kurën për budallallëkun dhe injorancën"



13:48

Futbollisti më i pasur në botë nuk ka skuadër: është i papunë me një pasuri prej 18 miliardë eurosh



13:43

Një i mitur fshihet poshtë autobusit të Valladolid dhe hyn në Spanjë: "Lojtarët dëgjuan zhurma"



12:15

Revolucion në Formula 1! Nga viti 2027, Çmimet e Mëdha më të shkurtra e rregulla të reja për ndërprerjet



11:49

Stërvitja e parë e Zidane si trajner i Francës me vetëm 12 lojtarë: disa ishin të shqetësuar

PAPARAZZI





21:08

Pas rikthimit në Britani, Meghan Markle bën daljen e parë publike

Meghan Markle është shfaqur në Britani për herë të parë pas rikthimit të bujshëm të saj dhe Princ Harryt nëseu...

Taylor Swift rikthehet në muzikë, zbulon projektin e ri

28:53



Zbulohet shkaku i vdekjes së Hayden Panettiere

19:26

Demi Moore nderohet me çmimin prestigjioz "Giving Tree Award"

19:29



Channing Tatum shpërthen pas akuzave se po sulmon fshehurazi Zoë Kravitz dhe Harry Styles

14:48

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.